



# Kriteret e KGTQ për Destinacionin

Versioni 2.0  
6 Dhjetor 2019

Indikatorët e Performancës dhe OZhQ-të

Miratuar zyrtarisht nga Grupi i Punës së Standardeve Ndërkombëtare të KGTQ dhe pranuar zyrtarisht nga Bordi i Drejtorëve të KGTQ si versioni i parë i Krieteve të KGTQ për Destinacionin sipas Rregulloreve të Statutit të KGTQ

© Këshilli Global për Turizëm të Qëndrueshëm, 2019, Të gjitha të Drejtat të Rezervuara  
Këshilli Global për Turizëm të Qëndrueshëm  
Kutia Postare 96503 - #51887  
Washington, DC 20090 USA  
info@gstcouncil.org  
www.gstcouncil.org

[www.gstcouncil.org](http://www.gstcouncil.org)

## Parathënie

Kriteret e Këshillit Global për Turizëm të Qëndrueshëm (KGTQ) u hartuan për të ofruar një konceptim unik të turizmit të qëndrueshëm. Kriteret e KGTQ për Destinacionet – jo-formalisht të njohura edhe si “KGTQ-D” - janë minimumi që çdo destinacion turistik duhet të aspirojë të përmbush. Ato janë të organizuara rreth katër temave kryesore: menaxhim i qëndrueshëm; ndikimet socio-ekonomike; ndikimet kulturore; dhe ndikimet mjedisore. Ato kanë zbatueshmëri në të gjithë sektorin e turizmit.

Kriteret e KGTQ janë hartuar dhe rishikuar me synimin t’i përmbahen Kodit të Vendosjes së Standardeve të Aleancës ISEAL, organ i miratuar për ofrimin e udhëzimeve mbi normat ndërkombëtare për zhvillimin e standardeve të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët. Rishikimi më i fundit i KGTQ-D u realizua në vitin 2019, bazuar në dy raunde konsultimesh me palët e interesuara. Informacioni mbi hartimin e kriterëve dhe planeve për rishikime në të ardhmen është i disponueshëm në [www.gstccouncil.org](http://www.gstccouncil.org).

## Përse shërbejnë Kriteret ?

Disa nga përdorimet e Kriterëve të KGTQ për Destinacionin përfshijnë si më poshtë:

- Shërbejnë si bazë për certifikimin për qëndrueshmëri.
- Shërbejnë si udhëzues bazë për destinacionet që dëshirojnë të bëhen më të qëndrueshëm.
- Ndihmojnë konsumatorët të identifikojnë destinacione me turizëm me qëndrueshmëri të fortë.
- Shërbejnë si statistika të përgjithshme për mediumet e informacionit për të njohur destinacionet dhe për të informuar publikun në lidhje me qëndrueshmërinë e tyre.
- Ndihmojnë në certifikim dhe programe të tjera vullnetare në nivel destinacioni për t’u siguruar që standardet e tyre plotësojnë një bazë të pranuar gjerësisht.
- Ju ofrojnë programeve qeveritare, joqeveritare dhe sektorit privat një pikënisje për zhvillimin e kërkesave për turizëm të qëndrueshëm.
- Shërbejnë si udhëzues bazë për organizmat arsimore dhe trajnuese, siç janë shkollat e turizmit dhe universitetet.
- Demonstrojnë drejtim që frymëzon të tjerët të veprojnë.

Kriteret tregojnë se çfarë duhet të bëhet, jo si do të bëhet ose nëse objektivi është arritur. Ky rol përmbushet nga treguesit e performancës, materialet mësimore përkatëse dhe aksesit në mjetet për zbatim, që të gjitha janë plotësues të domosdoshëm të Kriterëve të KGTQ.

## Për kë shërbejnë Kriteret?

KGTQ-D janë krijuar për destinacionet<sup>1</sup>. Kriteret nuk lidhen me një organizëm të posaçëm, por me një vend të caktuar që mund të identifikohet si unik. Kriteret thjesht kërkojnë që gjendja e përshkruar të tregojë situatën reale në atë destinacion, pavarësisht se cili organizëm mund të jetë përgjegjës për të ose si apo nga kush zbatohet ndonjë veprim përkatës.

<sup>1</sup> Nga Organizata Botërore e Turizmit (KBOBT) një destinacion përshkruhet si: “Një hapësirë fizike me ose pa kufij administrativ dhe/ose analitik në të cilën një vizitor mund të kalojë një natë. Është grupi (vendndodhje e përbashkët) i produkteve dhe shërbimeve, i veprimtarive dhe përvojave në të gjithë zinxhirin e turizmit dhe një njësi bazë e analizës së turizmit. Një destinacion përfshin aktorë të ndryshëm dhe ai mund të bashkëpunojë me të tjerë për të formuar destinacione më të mëdha”.

Fusha e veprimt të GSTC-D është e gjerë dhe Kriteret mund të zbatohen për një gamë të gjerë destinacionesh të cilat mund të jenë në çdo skaj të botës dhe të çfarëdollojtë (p. sh. urbane, rurale, malore, bregdetare ose të përziera). Kriteret mund të lidhen me destinacione të mëdha (p.sh. qytete ose rajone të mëdha) dhe ato të vogla (p.sh. parqe kombëtare, grupime të komuniteteve lokale, etj.)

Ndonëse KGTQ-D kanë të bëjnë me një vend, jo me një organizatë, shumë prej kriterëve gjithsesi mund të merren përsipër të zbatohen përmes një organizate të menaxhimit të destinacionit që është përgjegjëse për një qasje të koordinuar ndaj turizmit të qëndrueshëm në destinacion. Ekzistenca e një organizate të tillë është një kërkesë thelbësore e KGTQ-D, sikurse përcaktohet në Kriterin A1. Duhet të theksohet se një organizatë e tillë nuk është domosdoshmërisht një autoritet vendor ose një organ i sektorit publik dhe kërkon përfshirjen e sektorit publik dhe të atij privat. Disa nga kriteret i referohen ndërmarrjeve. Ato mund të jenë biznese individuale por ato mund të jenë edhe forma të tjera si objekte, operacione dhe sipërmarrje. Për shembull, ato mund të përfshijnë muze, festivale, ndërtesa publike dhe monumente, jo vetëm biznese tregtare siç janë hotelet ose pikat turistike me pagesë.

### Indikatorët e Performancës dhe OZhQ-të

Indikatorët e performancës të prezantuar këtu janë hartuar për të ofruar udhëzime për matjen e përputhshmërisë me kriteret. Ato nuk synojnë të jenë paketa përfundimtare apo gjithëpërfshirëse, por të ofrojnë një model pakete të plotë për përdoruesit e KGTQ-D ndërsa ata përgatisin paketat e tyre të indikatorëve. Në thelb, indikatorët e performancës propozojnë një listë të rrethanave, faktorëve, evidencave dhe veprimeve që duhen kërkuar në një destinacion kur bëhet vlerësimi i përputhshmërisë me kriteret.

Zbatimi i kriterëve do të ndihmojë një destinacion për të kontribuar në përmbushjen e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe 17 Objektive për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ). Për secilin prej kriterëve, është identifikuar një ose më shumë prej 17 OZhQ-ve, me të cilat ai lidhet drejtpërsëdrejti.

### Gjuha dhe Përkthimet

Anglishtja është gjuha zyrtare e Kriterëve të KGTQ dhe sistemit përkatës të tyre.

Përkthimet në gjuhë të tjera që shfaqen në faqen e internetit të KGTQ ose diku tjetër, do të përdoren për qëllime trajnimi dhe ndërgjegjësimi dhe nuk janë të autorizuar për përdorim në programet teknike, përfshirë certifikimin dhe akreditimin, përveçse kur përcaktohet posaçërisht me marrëveshje zyrtare midis KGTQ ose Organit të tij të Akreditimit të autorizuar dhe pronarit të standardit dhe/ose Organit të Certifikimit. Në rastin e përdorimit të autorizuar të një gjuhe tjetër përveç anglishtes, për çdo dyshim në lidhje me interpretimin e Kriterëve, si referencë do të përdoret versioni zyrtar i gjuhës angleze.

### Periudha e Tranzicionit

Periudhat e tranzicionit për të zëvendësuar Kriteret e KGTQ v1.0 me v2.0 për Destinacionin të janë në funksion të:

- Me qëllim përcaktimin e politikave për trajnime dhe qëllimeve të tjera që nuk lidhen me certifikimin, v2.0 duhet të hyjë në fuqi menjëherë.
- Pronarët e destinacionit /grupit të standardeve të akredituara nga KGTQ do të kenë një periudhë dy vjeçare për të qenë në përputhje me versionin e ri v2.0, deri më 31 dhjetor 2021. Pronarët mund të dëshirojnë të përshtatin standardin e tyre me rishikimet më herët, por duhet ta bëjnë këtë jo më vonë se 30 qershor 2021, për të lejuar kohë për çdo përshtatje të nevojshme të rishikimit nga KGTQ për pajtueshmërinë e ndryshimeve të bëra.
- Organet e Certifikimit të akredituara për të certifikuar destinacionet sipas Kriterëve të KGTQ për Destinacionin v1.0 duhet të kenë v2.0 të rishikuar të integruar plotësisht në sistemin e certifikimit me dëshmi të zbatimit të tij më hershëm, deri më 31 dhjetor 2021. Shërbimi normal i ri-akreditimit nuk do të shtyhet gjatë periudhës së tranzicionit. Pas Dhjetorit 2019, aplikantët e rinj për Akreditim, përpara se të paraqesin një kërkesë për Akreditim duhet të sigurohen që po përdorin KGTQ-D v2.0, ose një standard të Akredituar nga KGTQ që është ekuivalent me v2.0.

## Rishikimet e Krieteve të KGTQ

Ky version (v2.0) është miratuar zyrtarisht nga Bordi i Drejtorëve si versioni përfundimtar i Krieteve të KGTQ për Destinacionin (KGTQ-D), që prej 6 dhjetorit 2019.

Ky version i Krieteve të KGTQ për Destinacionin (v2.0) është rishikimi i parë që nga publikimi i tyre zyrtar në dhjetor 2013.




KGTQ do të kryejë rishikime periodike në jo më pak se pesë vjet pas rishikimit të mëparshëm, për të përcaktuar nëse versioni aktual është ende i përshtatshëm dhe nëse dhe kur duhet të fillojë një proces rishikimi zyrtar. Një rishikim tjetër i tillë ka të ngjarë të bëhet përafërsisht në dhjetor 2024. KGTQ mirëpret komente mbi Kriteret në çdo kohë përmes seksionit të Krieteve në [www.gstclaimil.org](http://www.gstclaimil.org). Nëse komentet ofrojnë evidenca të nevojës për të bërë një rishikim më herët se dhjetori 2024, KGTQ mund të kryejë një rishikim në një datë më të hershme.

## Struktura e Krieteve







Kriteret zbatohen në katër seksione, secili me dy ose tre nën-seksione, siç tregohet më poshtë. Renditja e seksioneve dhe nën-seksioneve në asnjë mënyrë nuk tregon rëndësinë relative të asnjë prej temave.




<p><b>SEKSIONI A: Menaxhimi i qëndrueshëm</b></p> <p>A(a) Struktura dhe korniza e menaxhimit</p> <p>A(b) Angazhimi i aktorëve</p> <p>A(c) Menaxhimi i presionit dhe ndryshimit</p>	<p><b>SEKSIONI C: Qëndrueshmëria Kulturore</b></p> <p>C(a) Mbrojtja e trashëgimisë kulturore</p> <p>C(b) Vizitat në site kulturore</p>
<p><b>SEKSIONI B: Qëndrueshmëria Socio-ekonomike</b></p> <p>B(a) Ofrimi i përfitimeve ekonomike lokale</p> <p>B(b) Mirëqenia sociale dhe impaktet.</p>	<p><b>SEKSIONI D: Qëndrueshmëria Mjedisore</b></p> <p>D(a) Ruajtja e trashëgimisë natyrore</p> <p>D(b) Menaxhimi i burimeve</p> <p>D(c) Menaxhimi i mbetjeve dhe emetimit të gazrave.</p>

## Kriteret e KGTQ për DESTINACIONIN v2.0

Kriteret	Indikatorët	OZhQ-të
<b>SEKSIONI A: Menaxhimi i Qëndrueshëm</b>		
<b><u>A(a) Struktura dhe Korniza e Menaxhimit</u></b>		
<p><b>A1 Përgjegjësia e Menaxhimit të Destinacionit</b></p> <p>Destinacioni ka një organizatë, departament, grup, ose komitet efikas përgjegjës për një qasje të koordinuar për turizëm të qëndrueshëm, me përfshirjen e sektorit privat, sektorit publik dhe shoqërisë civile. Ky grup ka përgjegjësi të përcaktuara siç është mbikëqyrja dhe ka aftësi zbatimi për menaxhimin e çështjeve socio-ekonomike, kulturore dhe mjedisore. Grupi financohet siç duhet, punon me një sërë organesh për menaxhimin e destinacionit, ka personel të mjaftueshëm (përfshi edhe personel me eksperiencë në qëndrueshmëri) dhe zbaton parimet e qëndrueshmërisë dhe transparencës në të gjitha operacionet dhe transaksionet e kryera</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Evidenca dokumentare që tregojnë strukturën e duhur dhe përgjegjësitë e grupit.</li> <li>Një plan financiar dhe buxheti përkatës që tregojnë burimet financiare aktuale dhe të së ardhmes.</li> <li>Evidenca të lidhjeve dhe angazhimit me organizma të tjera.</li> <li>Të dhëna të personelit të përhershëm dhe me kontrata, që tregojnë edhe eksperiencat përkatëse.</li> <li>Udhëzimet e menaxhimit dhe proceset, që demonstrojnë ndërgjegjësim dhe respektimin e parimeve të qëndrueshmërisë dhe transparencës në operacionet e punës dhe dhënien e kontratave.</li> </ol>	 
<p><b>A2 Strategjia e menaxhimit të destinacionit dhe plani i veprimit</b></p> <p>Destinacioni është krijuar dhe po zbaton një strategji shumëvjeçare për menaxhimin e destinacionit dhe planin e veprimit që është i disponueshëm publikisht, është i përshtatshëm për madhësinë e tij, është hartuar së bashku me aktorët e përfshirë dhe bazohet në parimet e qëndrueshmërisë. Strategjia përfshin identifikimin dhe vlerësimin e aseteve të turizmit dhe merr në konsideratë çështjet dhe risqet socio-ekonomike, kulturore dhe mjedisore. Strategjia lidhet me dhe influencon në hartimin e një politike më të gjerë për zhvillim të qëndrueshëm dhe me planin e veprimit.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Publikimi i një dokumenti që përcakton strategjinë dhe planin e veprimit aktual të destinacionit.</li> <li>Strategjia/plani është qartësisht i dukshëm dhe i disponueshëm në internet.</li> <li>Evidenca të konsultimeve me aktorët e përfshirë, takimeve, etj. për hartimin e planit të veprimit.</li> <li>Në përmbajtje të strategjisë dhe planit të veprimit ka referenca të parimeve të qëndrueshmërisë dhe të një vlerësimi të aseteve, çështjeve dhe risqeve.</li> <li>Referenca specifike në strategji/planin e veprimit të një politike më të gjerë për zhvillim të qëndrueshëm (përfshi zbatimin e OZhQ-ve) dhe anasjelltas.</li> </ol>	

<p><b>A3 Monitorimi dhe raportimi</b></p> <p>Destinacioni zbaton një sistem për monitorim dhe për t’ju përgjigjur çështjeve socio-ekonomike, kulturore dhe mjedisore si dhe impakteve të turizmit. Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet monitorohen rregullisht, vlerësohen dhe raportohen publikisht. Sistemi i monitorimit rishikohet periodikisht.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Indikatorë specifik të matshëm socio-ekonomik, kulturor dhe mjedisor dhe objektivat e identifikuar.</li> <li>Matja e këtyre indikatorëve e shoqëruar me regjistrimin e rezultateve dhe publikimin e tyre të paktën një herë në vit.</li> <li>Evidenca me shkrim të monitorimit dhe raportimit të veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve.</li> <li>Rishikime të mëparshme të sistemit të monitorimit dhe planifikimi për monitorime të ardhshme.</li> </ol>	
<p><b><u>A(b) Angazhimi i Aktorëve</u></b></p>		
<p><b>A4 Përfshirja e biznesit dhe standardet e qëndrueshmërisë</b></p> <p>Destinacioni informon rregullisht bizneset e tjera të përfshira në fushën e turizmit rreth problemeve të qëndrueshmërisë si dhe i inkurajon dhe mbështet ata që sipërmarrjet e tyre të bëhen më të qëndrueshme. Destinacioni promovon zbatimin e standardeve të qëndrueshmërisë duke promovuar zbatimin e standardeve të Miratuara nga KGTC-I dhe skemat e certifikimit të Akredituara nga GSTC-I për bizneset e turizmit, ku ata operojnë. Destinacioni publikon listën e bizneseve të certifikuara për qëndrueshmëri.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Evidenca të komunikimit të vazhdueshëm për çështje të qëndrueshmërisë së bizneseve (media, takime, kontakte të drejtpërdrejta, etj.)</li> <li>Mbështetje për qëndrueshmërinë dhe këshilla për bizneset e turizmit – të disponueshme dhe promovuara.</li> <li>Numri dhe përqindja e bizneseve të certifikuara për standardet e turizmit të qëndrueshëm (dhe nëse janë të miratuara/certifikuara nga KGTC), me synime për zgjerim të mëtejshëm.</li> <li>Evidenca të promovimit të skemave të certifikimit.</li> <li>Lista e bizneseve të certifikuara në fushën e turizmit, e përditësuar.</li> </ol>	 
<p><b>A5 Përfshirja e banorëve dhe feedback-u</b></p> <p>Destinacioni mundëson dhe promovon pjesëmarrjen e publikut në planin dhe menaxhimin e një destinacioni të qëndrueshëm. Aspiratat, shqetësimet dhe kënaqësia e komunitetit për turizëm të qëndrueshëm dhe menaxhimin e destinacionit monitorohen rregullisht dhe raportohen publikisht, dhe si reagim ndaj tyre merren masat e duhura. Destinacioni ka një sistem për përmirësimin e perceptimit lokal për mundësitë dhe sfidat e turizmit të qëndrueshëm dhe për ngritjen e kapaciteteve lokale për të reaguar ndaj tyre.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Evidenca të promovimit dhe krijimit të mundësive për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin/ menaxhimin e destinacionit.</li> <li>Informacion për llojin dhe nivelin e pjesëmarrjes</li> <li>Anketime të banorëve dhe instrumente të tjerë për feedback sistematik në lidhje me çështjet e turizmit.</li> <li>Evidenca të veprimeve të ndërmarra si reagim ndaj feedback-ut të banorëve.</li> <li>Banorëve ju ofrohen programe informimi, edukimi, dhe trajnimi për turizmin.</li> </ol>	 

<p><b>A6 Përfshirja e vizitorëve dhe feedback-u</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për monitorimin dhe raportimin publik të kënaqësisë së vizitorëve, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së destinacionit, për eksperiencat dhe, nëse është e nevojshme, të reagojë. Vizitorët informohen rreth çështjeve të qëndrueshmërisë në destinacion dhe rolit që ata mund të luajnë për adresimin e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Anketime të vizitorëve (dhe mekanizma të tjerë feedback-u) – janë realizuar dhe raportuar.</li> <li>b. Anketimet dhe feedback-u përfshin reagimin e vizitorëve ndaj çështjeve të qëndrueshmërisë.</li> <li>c. Evidenca të veprimeve të ndërmarra si reagim ndaj konkluzioneve të nxjerra nga anketimet/feedback-u.</li> <li>d. Shembuj të informacionit të vizitorëve në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë dhe si të reagojmë ndaj tyre.</li> </ul>	 
<p><b>A7 Promocioni dhe informacioni</b></p> <p>Materialet e promocionit dhe informacioni për vizitorët rreth destinacionit janë të vërteta në lidhje me produktet, shërbimet, dhe pretendimet e tij për qëndrueshmëri. Mesazhet e marketingut dhe komunikime të tjera reflektojnë vlerat e destinacionit dhe qasjen e tij ndaj qëndrueshmërisë dhe trajtojnë asetet e komuniteteve lokale, ato natyrore dhe kulturore me respekt.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Materiale aktuale informuese dhe promovionale me përmbajtje të përshtatshme.</li> <li>b. Ekziston një proces për të kontrolluar saktësinë dhe përshtatshmërinë e promocionit dhe informacionit të destinacionit.</li> <li>c. Evidenca të konsultimeve me komunitetet lokale dhe organet përgjegjëse për çështjet mjedisore dhe kulturore; përmbajtja dhe dërgimi i korrespondencës.</li> </ul>	 
<p><b><u>A(c) Menaxhimi i presionit dhe ndryshimit</u></b></p>		
<p><b>A8 Menaxhimi i volumit dhe veprimtarive të vizitorëve</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për menaxhimin e vizitorëve, i cili rishikohet rregullisht. Ndërmerren veprime për monitorimin dhe menaxhimin e volumit dhe aktiviteteve të vizitorëve, dhe për reduktimin ose shtimin e numrit të tyre sipas nevojës dhe në vendndodhje të caktuara, duke punuar për të balancuar nevojat ekonomike të komunitetit lokal dhe trashëgiminë kulturore dhe mjedisore të komunitetit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Strategjia e menaxhimit dhe plani i veprimit të destinacionit adresojnë volumin sezonal dhe shpërndarjen në kohë të vizitave.</li> <li>b. Bëhet monitorimi i volumit të vizitorëve gjatë vitit, përfshi edhe destinacionet me fluks më të lartë.</li> <li>c. Impaktet e volumit dhe aktiviteteve të vizitorëve janë identifikuar përmes vëzhgimit dhe feedback-ut të komunitetit dhe aktorëve të përfshirë.</li> <li>d. Janë ndërmarr veprime për menaxhimin e fluksit të vizitorëve dhe impakteve përkatëse.</li> <li>e. Strategjia e marketingut dhe përzgjedhja e tregjeve të synuara merr në konsideratë modelet e vizitave, impaktin e aktiviteteve dhe nevojat e destinacionit.</li> </ul>	 
<p><b>A9 Rregulloret e Planifikimit dhe kontrolli i zhvillimit</b></p> <p>Për planifikim, destinacioni ka udhëzues, rregullore dhe/ose politika që kontrollojnë zhvillimin e vendndodhjes dhe natyrës dhe që kërkojnë vlerësime të</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Politika/rregullore/udhëzues specifik që kontrollojnë zhvillimin – janë dokumentuar dhe identifikuar sipas titullit dhe datës.</li> </ul>	



<p>Destinacioni ka një sistem për monitorimin dhe raportimin publik të kënaqësisë së vizitorëve, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së destinacionit, për eksperiencat dhe, nëse është e nevojshme, të reagojë. Vizitorët informohen rreth çështjeve të qëndrueshmërisë në destinacion dhe rolit që ata mund të luajnë për adresimin e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>b. Kërkesat për vlerësimin e impakteve, që mbulojnë impaktin mjedisor, ekonomik, dhe socio-kulturor në nivel të mjaftueshëm për të adresuar çështjet afatgjata për destinacionin, janë përgatitur.</li> <li>c. Rregullore të posaçme për marrjen me qira për qëllime turizmi, me evidenca që provojnë aplikimin dhe zbatimin e tyre.</li> <li>d. Evidenca të pjesëmarrjes së publikut në hartimin e politikave/rregulloreve/udhëzuesve.</li> <li>e. Evidenca të konsultimeve me dhe të dakordësimit të popullatës autoktone ose grupeve të vogla etnike kur zhvillimet për turizëm janë propozuar apo janë bërë në territoret e tyre.</li> <li>f. Evidenca të komunikimit dhe zbatimit të politikave/rregulloreve/udhëzuesve në fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit.</li> </ul>	 
<p><b>A10 Adaptimi i ndryshimeve klimatike</b></p> <p>Destinacioni identifikon risqet dhe mundësitë që lidhen me ndryshimet klimatike. Strategjitë e adaptimit të ndryshimeve klimatike janë zbatuar për vendndodhjen, planifikimin, zhvillimin dhe menaxhimin e bizneseve të turizmit.</p> <p>Informacioni për ndryshimet klimatike të parashikuara, risqet përkatëse dhe kushtet në të ardhmen ofrohet për banorët, bizneset dhe vizitorët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Strategjia e menaxhimit të destinacionit dhe plani i veprimit identifikojnë dhe adresojnë çështjet klimatike.</li> <li>b. Rregulloret, udhëzuesit dhe përcaktimi i zonës për zhvillimin dhe aktivitetet e turizmit rregullojnë pasojat e ndryshimeve klimatike.</li> <li>c. Vlerësimi i riskut mjedisor, që mbulon risqet aktuale dhe ato në të ardhmen – është kryer dhe është i disponueshëm për publikun.</li> <li>d. Evidenca që është marr në konsideratë impakti në, dhe kontributet e ekosistemeve lokale në adaptimin e ndryshimeve klimatike.</li> <li>e. Informacion për ndryshimet klimatike që është vënë në dispozicion të publikut.</li> </ul>	
<p><b>A11 Menaxhimi i riskut dhe krizës</b></p> <p>Destinacioni ka një plan për reduktimin e riskut, menaxhimin e krizës dhe reagimin në rast emergjence që i përshtatet destinacionit. Elementët thelbësor të planit u janë komunikuar banorëve, vizitorëve dhe bizneseve. Janë hartuar procedurat dhe siguruar burimet për zbatimin e planit, i cili përditësohet rregullisht.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Destinacioni e ka të dokumentuar planin për reduktimin e riskut dhe reagimin në rast emergjence për turizmin në destinacion.</li> <li>b. Plani parashikon një gamë të gjerë të risqeve, përfshi katastrofat natyrore, terrorizmin, shëndetin, shterimin e burimeve dhe të tjera në varësi të zonës.</li> <li>c. Procedurat e komunikimit për përdorim gjatë dhe pas emergjencës janë identifikuar.</li> <li>d. Programe për shpërndarjen e informacionit dhe ofrimin e trajnimeve për menaxhimin e risqeve dhe krizës.</li> </ul>	 







## SEKSIONI B: Qëndrueshmëria Socio-ekonomike

### B(a) Ofrimi i përfitimeve ekonomike lokale






<p>Kontributi ekonomik i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i turizmit në ekonominë e destinacionit monitorohet dhe raportohet publikisht. Masat e përshtatshme mund të përfshijnë nivelet e volumit të vizitorëve, shpenzimet e vizitorëve, punësimi dhe investimet si dhe evidenca për ndarjen e përfitimeve ekonomike.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Programi për mbledhjen e të dhënave ekonomike.</li> <li>Raporte vjetore për kontributet ekonomike të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të turizmit në destinacion.</li> <li>Të dhëna që mbulojnë një sërë masash me impakt ekonomik (p.sh. volumi, shpenzimet, punësimi, investimet dhe ndarja e përfitimit ekonomik në destinacion).</li> </ol>	  
<p><b>B2 Puna e mirë dhe mundësitë për karrierë</b></p> <p>Destinacioni inkurajon dhe mbështet mundësitë për karrierë dhe trajnim në sektorin e turizmit. Bizneset e turizmit të destinacionit angazhohen të ofrojnë mundësi të barabarta punësimi, trajnimi dhe progresi, një mjedis pune të sigurt dhe të siguruar, dhe të gjithëve t'u ofrohet një pagë minimale .</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ofrimi i trajnimeve, programeve/kurseve për aftësitë e nevojshme, të disponueshme në zonë.</li> <li>Deklarata zotimi nga bizneset e turizmit për ofrimin e mundësive të përshtatshme për punësim ose karrierë.</li> <li>Mundësitë për trajnim dhe punësim promovohen dhe shfrytëzohen nga njerëzit e zonës, përfshi gratë, të rinjtë, pakicat, dhe personat me aftësi të kufizuara.</li> <li>Kanalet për të kontrolluar kushtet e punës dhe pranimin/trajtimin e ankesave (p.sh. përfshirje e Sindikatave të Punës/Punonjësve).</li> </ol>	   
<p><b>B3 Mbështetja e sipërmarrësve vendas dhe tregtia e ndershme</b></p> <p>Destinacioni inkurajon që shpenzimet e turizmit të rezervohen për ekonominë lokale duke mbështetur sipërmarrjet lokale, furnitorët lokal dhe investimet e qëndrueshme. Ai promovon prodhimin dhe blerjen e produkteve lokale pasqyrojnë natyrën dhe kulturën e zonës. Shitja e këtyre produkteve bëhet mbi parimet e tregtisë</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Këshillime, financa ose mbështetje të tjera- të disponueshme në destinacion -për SME-të që kanë lidhje me turizmin.</li> <li>Asistencë për akses në treg për SME-të lokale që kanë lidhje me turizmin.</li> <li>Veprime për të inkurajuar dhe mbështetur biznese lokale të turizmit të blejnë mallra dhe shërbime lokale.</li> </ol>	 






<p>së ndershme. Këto produkte mund të përfshijnë produkte ushqimore dhe pije, punime artizanale, performanca artistike, produkte bujqësore, etj.</p>	<p>Iniciativa për të ndihmuar fermerët, artizanët dhe prodhuesit e produkteve ushqimore të përfshihen në proceset dhe veprimtaritë e sektorit të turizmit.</p> <p>e. Prodhimet dhe punimet artizanale vendase janë identifikuar, promovuar dhe të gatshme për t’ju shitur vizitorëve në destinacion.</p>	
<p><b><u>B(b) Mirëqenia Sociale dhe impaktet</u></b></p>		
<p><b>B4 Mbështetje për komunitetin</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem që mundëson dhe inkurajon bizneset, vizitorët dhe publikun të kontribuojnë me përgjegjshmëri në iniciativat e komunitetit dhe ato të qëndrueshmërisë.</p>	<p>a. Mbështetja për komunitetin lokal dhe iniciativat për qëndrueshmëri nga bizneset lokale të turizmit është inkurajuar dhe promovuar.</p> <p>b. Skemat ekzistojnë dhe janë promovuar për vizitorët që të mbështesin komunitetin lokal dhe iniciativa të qëndrueshmërisë.</p> <p>c. Vullnetarizmi dhe angazhimi në komunitet nuk ka të bëjë me ndërhyrje apo shfrytëzim.</p>	 
<p><b>B5 Parandalimi i shfrytëzimit dhe diskriminimit</b></p> <p>Destinacioni mbështet standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ai ka ligje, praktika dhe një kod sjellje të vendosur për të parandaluar dhe raportuar trafikimin e qenieve njerëzore, skllavërinë modern dhe tregtare, seksuale, ose çdo formë tjetër shfrytëzimi, diskriminimi dhe ngacmimi kundrejt kujt do veçanërisht fëmijëve, adoleshentëve, grave, LGBT dhe minoriteteve. Ligjet dhe praktikat e krijuara komunikohen dhe zbatohen publikisht.</p>	<p>a. Referenca (titulli, data) të ligjeve specifike që zbatohen në destinacion në lidhje me të drejtat e njeriut, shfrytëzimin, diskriminimin dhe ngacmimin.</p> <p>b. Evidenca të komunikimit dhe zbatimit të ligjeve të sipërpërmendura dhe praktikave të mira përkatëse (përfshi bizneset e turizmit dhe vizitorët.)</p> <p>c. Analiza e riskut dhe impakteve në lidhje me të drejtat e njeriut, përfshi trafikun e qenieve njerëzore, skllavërinë moderne dhepunën e të miturve – zhvillohet rregullisht.</p> <p>d. Destinacioni dhe lojtarët kryesorë në sektorin e turizmit janë firmëtarët e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Udhëtim dhe Turizëm.</p>	 
<p><b>B6 Të drejtat e pronësisë dhe përdoruesit</b></p> <p>Ligjet dhe rregulloret në lidhje me të drejtat dhe blerjet e pronave janë të dokumentuara dhe zbatohen. Ato janë në përputhje me të drejtat komunale dhe autoktone, garantojnë konsultim me publikun dhe nuk autorizojnë zhvendosje pa marr pëlqimin paraprak të lirë dhe të informuar dhe pa garantuar kompensim të drejtë dhe të paanshëm. Ligjet dhe rregulloret mbrojnë gjithashtu të drejtat e përdoruesit dhe të drejtat për akses në burimet kryesore.</p>	<p>a. Referenca (titulli, data) të ligjeve specifike që zbatohen në destinacion në lidhje me të drejtat dhe blerjen e pronës, të drejtat e përdoruesit dhe të drejtat për akses në burimet kryesore.</p> <p>b. Referenca në ligjet e më sipërme për të drejtat komunale dhe autoktone, konsultimet publike dhe zhvendosjet.</p> <p>c. Evidenca të zbatimit të ligjeve të sipërpërmendura në kontekstin e zhvillimit dhe aktiviteteve të turizmit.</p>	 

	d. Evidenca të konsultimeve me komunitetin, dhënies së pëlqimit dhe kompensimit.	
<p><b>B7 Mbrojtja dhe siguria</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për të monitoruar, parandaluar, raportuar publikisht dhe reaguar ndaj krimit, mbrojtjes dhe rreziqeve shëndetësore, sistem që adreson nevojat si të vizitorëve ashtu edhe të rezidentëve.</p>	<p>a. Siguria dhe shërbimet shëndetësore janë të mirë krijuara dhe janë aktive në destinacion.</p> <p>b. Nevojat e vizitorëve janë identifikuar dhe adresuar për të ofruar siguri dhe shërbime shëndetësore.</p> <p>c. Mjediset e turizmit janë inspektuar për pajtueshmëri me standardet e sigurisë dhe higjienës.</p>	 
<p><b>B8 Akses për të gjithë</b></p> <p>Kur është e mundur, sitet, mjediset dhe, shërbimet, përfshi ato me rëndësi natyrore dhe kulturore, janë të aksesueshme për të gjithë, përfshi personat me aftësi të kufizuara dhe për të tjerët me nevoja të veçanta për akses ose nevoja të tjera të veçanta. Kur sitet dhe godinat nuk janë drejtpërsëdrejti të aksesueshme, aksesimi mundësohet përmes planifikimit dhe aplikimit të zgjidhjeve që marrin në konsideratë si integritetin e site ashtu edhe akomodimin e pranueshëm për personat me kërkesa të veçanta për akses. Informacioni vihet në dispozicion në pikat kyçe të aksesit, në godinat dhe mjediset e shërbimit.</p>	<p>a. Ekzistenca e rregulloreve dhe standardeve për mundësinë e aksesit të mjedisëve, godinave, dhe shërbimeve turistike.</p> <p>b. Zbatimi i qëndrueshëm i standardeve në godinat publike.</p> <p>c. Të dhëna për masën/proporcionin e siteve dhe godinave që janë të aksesueshme.</p> <p>d. Evidenca të programeve për përmirësimin e aksesit për personat me një gamë nevojash për akses.</p> <p>e. Informacioni për aksesueshmërinë është i përfshirë në komunikimet rreth destinacionit në tërësi.</p> <p>f. Hollësitë për aksesueshmërinë janë përfshirë në informacionin për vizitorët rreth siteve kryesore.</p>	 

## SEKSIONI C: Qëndrueshmëria kulturore

### C(a) Mbrojta e trashëgimisë kulturore




<p><b>C1 Mbrojta e aseteve kulturore</b></p> <p>Destinacioni ka një politikë dhe sistem për të vlerësuar, rehabilituar, dhe mbrojtur asetet kulturore, përfshi trashëgiminë e ndërtuar dhe peizazhet kulturore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Listat e aseteve kulturore, përfshi vlerësimin dhe informacion për çmueshmërinë e tyre.</li> <li>Programi për rehabilitimin dhe mbrojtjen e aseteve.</li> <li>Mekanizma për përdorimin e të ardhurave nga turizmi për të mbështetur mbrojtjen e aseteve kulturore.</li> </ol>	
<p><b>C2 Artefakte kulturore</b></p> <p>Destinacioni ka ligje që rregullojnë siç duhet shitjen, tregtimin, ekspozimin, ose dhurimin e artefakteve historike dhe arkeologjike. Ligjet zbatohen dhe janë të disponueshme publikisht, përfshirë bizneset e turizmit dhe vizitorët.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Referenca të ligjeve përkatëse në lidhje me artefaktet historike që zbatohen në destinacion (titulli, data).</li> <li>Evidenca që ligjet përkatëse u janë bërë me dije bizneseve të turizmit dhe vizitorëve.</li> <li>Evidenca të zbatimit të ligjeve përkatëse.</li> </ol>	
<p><b>C3 Trashëgimia jo-materiale</b></p> <p>Destinacioni mbështet festimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jo-materiale, përfshi traditat lokale, artin, muzikën, gjuhën, gastronominë dhe aspekte të tjera të identitetit dhe veçantisë. Prezantimi, përsëritja dhe interpretimi i kulturës dhe traditave të të jetuarit është çështje e ndjeshme dhe e respektuar, pasi përfshin dhe u sjell përfitime komuniteteve lokale dhe u ofron vizitorëve një eksperiencë autentike dhe unike.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Identifikimi dhe listimi i trashëgimisë kulturore jo-materiale.</li> <li>Shembuj të festimeve dhe eksperiencave të vizitorëve të trashëgimisë kulturore jo-materiale (aktivitete, produkte të veçantë etj.)</li> <li>Evidenca të përfshirjes së komuniteteve lokale dhe autoktone në përgatitjen dhe ofrimin e eksperiencave për vizitorët, bazuar në trashëgiminë kulturore jo-materiale.</li> <li>Feedback nga vizitorët dhe komunitetet lokale për ofrimin e eksperiencave të trashëgimisë jo-materiale.</li> </ol>	 
<p><b>C4 Aksesit Tradicional</b></p> <p>Destinacioni monitoron, mbron, dhe kur lind nevoja rehabiliton ose restauron aksesin e komunitetit lokal në site natyrore dhe kulturore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi i aksesueshmërisë së komunitetit lokal në site kulturore dhe natyrore.</li> <li>Evidenca të përfshirjes së komunitetit lokal në lidhje me aksesin tradicional.</li> <li>Veprime specifike për të mbrojtur dhe/ose rehabilituar aksesin e komunitetit lokal.</li> </ol>	

<p><b>C5 Pronësia Intelektuale</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për të kontribuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale të komuniteteve dhe individëve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Referenca të ligjeve për pronësinë intelektuale që zbatohen në destinacion (titulli, data).</li> <li>Informimi i aktorëve të përfshirë në sektorin e turizmit rreth the drejtave të pronësisë intelektuale.</li> <li>Evidenca që të drejtat për pronësinë intelektuale janë mbrojtur gjatë zhvillimit të eksperiencave kulturore për vizitorët.</li> </ol>	
<p><b><u>C(b) Vizitat në site kulturore</u></b></p>		
<p><b>C6 Menaxhimi i vizitorëve në site kulturore</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për menaxhimin e vizitorëve në dhe përfaqësiteve kulturore. Sistemi merr parasysh karakteristikat e tyre, kapacitetin dhe ndjeshmërinë dhe përpiqet të rregullojë fluksin e vizitorëve dhe të minimizojë impaktet negative. Vizitorëve, operatorëve dhe drejtuesve të guidave turistike u vihen në dispozicion, para dhe gjatë vizitës, udhëzues për sjelljen në site sensitive dhe veprimtari kulturore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi i fluksit të vizitorëve dhe impaktit në site kulturore, me rezultatet që shpërndahen në gjithë destinacionin.</li> <li>Evidenca të veprimeve për menaxhimin e impakteve të turizmit në ose përfaqësiteve turistike.</li> <li>Ekzistenca dhe shpërndarja e udhëzimeve të publikuara për sjelljen e vizitorëve në site sensitive dhe veprimtari kulturore dhe monitorimi periodik i zbatimit të tyre.</li> <li>Kodi i praktikave për operatorët dhe drejtuesit e guidave turistike për menaxhimin e vizitorëve në sitet kulturore.</li> <li>Ofrimi i trajnimeve për drejtuesit e guidave.</li> </ol>	 
<p><b>C7 Interpretimi i Siteve</b></p> <p>Ofrohet material interpretimi korrekt, i cili informon vizitorët rreth rëndësisë së aspekteve kulturore dhe natyrore të siteve që ata vizitojnë. Informacioni është i përshtatshëm nga pikëpamja kulturore, i përgatitur në bashkëpunim me komunitetin mikpritës, dhe i transmetuar qartësisht në gjuhët përkatëse të vizitorëve dhe rezidentëve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ofrimi i materialeve informuese dhe interpretuese për sitet dhe broshurat që janë të disponueshme para mbërritjes.</li> <li>Evidenca që materiali interpretues është përgatitur pas hulumtimeve të shumta dhe është i saktë.</li> <li>Material interpretues që identifikon rëndësinë dhe ndjeshmërinë /brishtësinë e siteve.</li> <li>Evidenca që komuniteti mikpritës ka bashkëpunuar në përgatitjen e materialit interpretues përkatës.</li> <li>Materiali interpretues është i disponueshëm në gjuhët përkatëse.</li> </ol>	 

## SEKSIONI D: Qëndrueshmëria mjedisore

### D(a) Ruajtja e trashëgimisë natyrore

<p><b>D1 Mbrojtja e mjedisve sensitive</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për të monitoruar, parandaluar, raportuar publikisht dhe reaguar ndaj kimit, mbrojtjes dhe rreziqeve shëndetësore, sistem që adreson nevojat si të vizitorëve ashtu edhe të rezidentëve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Lista e siteve dhe asetëve të trashëgimisë natyrore, që tregon tipin, statusin e mbrojtjes dhe cënueshmërinë.</li> <li>Programe për mbrojtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore.</li> <li>Programe për zhdukjen dhe kontrollin e specieve invazive.</li> <li>Veprime për të identifikuar, monitoruar dhe reduktuar impaktet e turizmit në biodiversitet dhe trashëgiminë natyrore.</li> <li>Mekanizma për përdorimin e të ardhurave nga turizmi për të mbështetur ruajtjen e asetëve natyrore.</li> <li>Komunikime me vizitorët dhe bizneset për reduktimin e përhapjes së specieve të huaja.</li> </ol>	 
<p><b>D2 Menaxhimi në sitet natyrore</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për menaxhimin e vizitorëve në dhe për qark siteve natyrore, i cili merr në konsideratë karakteristikat e tyre, kapacitetin dhe sensitivitetin dhe përpiqet të optimizojë fluksin e vizitorëve dhe minimizojë impaktet negative. Vizitorëve, operatorëve turistik dhe drejtuesve të guidave turistike u vihen në dispozicion, para dhe gjatë vizitës, udhëzues për mënyrën e sjelljes në site sensitive.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi i fluksit të vizitorëve dhe impaktit në sitet natyrore, me rezultatet që shpërndahen në gjithë destinacionin.</li> <li>Evidenca të veprimeve për menaxhimin dhe reduktimin e impakteve të turizmit në ose për qark siteve natyrore.</li> <li>Ekzistenca dhe shpërndarja e udhëzuesve të publikuar për sjelljen e vizitorëve në sitet sensitive, dhe monitorimi periodik i zbatueshmërisë.</li> <li>Kodi i praktikave për operatorët turistik dhe drejtuesit e guidave turistike për menaxhimin e siteve natyrore.</li> <li>Bashkëpunim me organet lokale të mbrojtjes për të identifikuar risqet mjedisore të lidhura me turizmin dhe masat për reduktimin e tyre.</li> <li>Ofrimi i trajnimeve për drejtuesit e guidave.</li> </ol>	 
<p><b>D3 Ndërveprimi me jetën e egër</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për të garantuar përputhshmërinë me ligjet dhe standardet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për ndërveprimet me kafshët e egra.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Referenca (titulli, data) të ligjeve ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale që zbatohen në destinacion në lidhje me ndërveprimin me kafshët e egra.</li> <li>Përqaftimi i standardeve ndërkombëtare për vëzhgimin e kafshëve të egra, si speciet detare edhe ato tokësore.</li> </ol>	

<p>Ndërveprimet me kafshët e egra që lëvizin lirisht, duke marr parasysh impaktet totale, nuk janë invazive dhe menaxhohen me përgjegjshmëri për të shmangur impaktet negative në kafshët në fjalë dhe në qëndrueshmërinë dhe sjelljen e këtyre popullatave në natyrë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>c. Shpërndarja e kodit të praktikave për ndërveprimin me kafshët e egra, përfshi vëzhgimin e tyre, që pasqyron standardet ndërkombëtare.</li> <li>d. Sistemi për të kontrolluar përputhshmërinë me rregulloret dhe kodin e praktikave në operacionet turistike.</li> <li>e. Veprimet për monitorimin e mirëqenies së kafshëve të egra dhe minimizimi i shqetësimit të tyre, në vendet ku ndodhin ndërveprimet.</li> <li>f. Ofrimi i informacionit për vizitorët në lidhje me rrezikun nga ndërveprimi me kafshët e egra, siç është prekja ose të ushqyerit.</li> </ul>	
<p><b>D4 Shfrytëzimi i Specieve dhe mirëqenia e kafshëve</b></p> <p>Destinacioni ka një sistem për të garantuar përputhshmërinë me ligjet dhe standardet lokale dhe ndërkombëtare që kërkojnë garantimin e mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e specieve (kafshëve, bimëve dhe gjithë organizmave të gjallë). Kjo përfshin grumbullimin ose kapjen, tregtimin, ekspozimin dhe shitjen e specieve të egra dhe produkteve të tyre. Asnjë specie e kafshëve të egra nuk mund të kapet, mbarështohet ose mbahet në kafaz, përveçse nga personat e autorizuar dhe me pajisjet përkatëse dhe për aktivitetet e lejuara me rregullore. Strehimi, kujdesi dhe trajtimi i kafshëve të egra apo shtëpiake plotëson standardet më të larta të mirëqenies së kafshëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Referenca (titulli, data) të ligjeve, standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale që zbatohen në destinacion në lidhje me mirëqenien dhe ruajtjen e specieve.</li> <li>b. Njoftimi i bizneseve të turizmit dhe guidave rreth ligjeve, standardeve dhe udhëzuesve.</li> <li>c. Një sistem për inspektimin e kushteve të kafshëve të egra dhe shtëpiake të mbyllura në kafaz, përfshi strehimin dhe trajtimin e tyre.</li> <li>d. Licencimi dhe kontrolli i kualifikimeve të personelit përgjegjës për kafshët e egra të kapura.</li> <li>e. Veprime për promovimin e Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES) në sektorin e turizmit dhe garantimi i pajtueshmërisë me të.</li> <li>f. Ofrimi i informacionit për vizitorët për të shmangur tregtinë e specieve të rrezikuara, p.sh. me blerjen e suvenirëve që vijnë nga speciet e kërcënuara të jetës së egër të shpallura nga IUCN ose CITES.</li> <li>g. Zbatimi i legjislacionit për të garantuar që ndonjë aktivitet gjuetie është pjesë e qasjes me bazë shkencore, i menaxhuar siç duhet dhe i zbatuar me përpikëri.</li> </ul>	 

**D(b) Menaxhimi i burimeve**

<p><b>D5 Kursimi i Energjisë</b></p> <p>Destinacioni ka objektiva për reduktimin e konsumit të energjisë, përmirësimin e efikasitetit në përdorimin e energjisë, si dhe shtimin e përdorimit të energjisë së rinovueshme. Destinacioni ka një sistem për të inkurajuar bizneset të matin, monitorojnë, reduktojnë, dhe raportojnë publikisht kontributin e tyre për këto objektiva.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Objektivat e konsumit të energjisë reklamohen dhe promovohen.</li> <li>b. Programe për të rritur efikasitetin e energjisë – p.sh.promovimi dhe përkrahja e izolimit.</li> <li>c. Investime për energjinë e rinovueshme dhe përqindja e totalit të furnizimit/konsumimit.</li> <li>d. Mbështetje dhe stimuj për monitorimin e energjisë dhe reduktimit të përdorimit nga bizneset.</li> </ul>	
<p><b>D6 Administrimi i ujit</b></p> <p>Destinacioni inkurajon bizneset të matin, monitorojnë, raportojnë publikisht dhe menaxhojnë përdorimin e ujit. Rreziku i mungesës së ujit në destinacion vlerësohet dhe dokumentohet. Në rastet kur rreziku i mungesës së ujit është i lartë, identifikohen objektivat për administrimin e ujit, të cilat ndiqen me rigorozitet nga bizneset, për të garantuar që përdorimi i ujit nga turizmi nuk bie ndesh me nevojat e komuniteteve lokale dhe ekosistemeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Ofrimi i këshillimeve dhe mbështetje për monitorimin dhe reduktimin e përdorimit të ujit nga bizneset.</li> <li>b. Program për vlerësimin e rrezikut të mungesës së ujit.</li> <li>c. Vendosja, publikimi dhe zbatimi i objektivave për administrimin e ujit, në rastet kur rreziku i mungesës së ujit është vlerësuar si i lartë.</li> <li>d. Monitorimi dhe kontrolli i burimeve dhe volumit të ujit të përdorur për qëllime turizmi dhe impaktet në komunitetet lokale dhe ekosistemet. Promovimi dhe kontrolli i zbatimit të objektivave nga bizneset e turizmit.</li> <li>e. Informimi i vizitorëve për rrezikun e mungesës së ujit dhe minimizimi i përdorimit të ujit.</li> </ul>	
<p><b>D7 Cilësia e ujit</b></p> <p>Destinacioni monitoron cilësinë e ujit për qëllime pirje, argëtimi dhe ekologjike, duke përdorur standardet e cilësisë. Rezultatet e monitorimit janë të disponueshme publikisht, dhe destinacioni ka një sistem që reagon menjëherë ndaj çështjeve të cilësisë së ujit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Programi për monitorimin e cilësisë së ujit</li> <li>b. Ekzistenca e të dhënave dhe raporteve për cilësinë e ujit.</li> <li>c. Monitorimi i ujit për larje, me certifikimin dhe identifikimin e vendndodhjeve që plotësojnë standardet.</li> <li>d. Evidenca të veprimeve për përmirësimin e cilësisë së ujit.</li> <li>e. Informacion për vizitorët për cilësinë e ujit të pijshëm në zonë, për të inkurajuar përdorimin e tij si alternativë të ujit në shishe.</li> </ul>	 



**D(c) Menaxhimi i mbetjeve dhe shkarkimit të gazrave**

**D8 Ujërat e zeza**

Destinatacioni ka udhëzime të qarta dhe që zbatohen për vendosjen, mirëmbajtjen dhe testimin e shkarkimeve nga rezervuari septik dhe sistemet e trajtimit të ujërave të zeza. Destinacioni sigurohet që uji i përdorur trajtohet siç duhet dhe ripërdoret ose shkarkohet në mënyrë të sigurt pa impakte negative në popullatën lokale dhe mjedis.

- a. Udhëzime dhe rregullore me shkrim për trajtimin e ujërave të zeza.
- b. Sistem për zbatimin e udhëzimeve nëpër biznese.
- c. Monitorimi/testimi i ujit të përdorur që shkarkohet.
- d. Sigurimi i sistemeve komunal të trajtimit të qëndrueshëm të ujërave, për përdorim nga sektori i turizmit, kur është e mundur dhe e përshtatshme.



**D9 Mbetjet e ngurta**

Destinacioni mat dhe raporton nxjerrjen e mbetjeve dhe vendos objektiva për reduktimin e tyre. Ai sigurohet që mbetjet e ngurta të përpunohen siç duhet dhe të mos çohen në fushën e grumbullimit të plehrave, duke përdorur një sistem grumbullimi dhe riciklimi me shumë ndarëse, i cili i ndan mbetjet sipas llojit.

Destinacioni inkurajon bizneset të shmangin, reduktojnë, ripërdorin dhe, të riciklojnë mbetjet e ngurta, përfshi mbetjet ushqimore. Ndërmerren veprime për eliminimin ose reduktimin e përdorimit të pajisjeve një-përdorimëshe, veçanërisht atyre plastike. Ndonjë mbetje e ngurtë që nuk ripërdoret ose nuk riciklohet depozitohet në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

- a. Programi për monitorimin e mbetjeve, me rezultatet dhe objektivat e publikuar.
- b. Fushata/këshillime/mbështetje për bizneset e turizmit për menaxhimin e mbetjeve, përfshi mbetjet ushqimore.
- c. Fushatë për reduktimin/eliminimin e pajisjeve një-përdorimëshe, veçanërisht atyre plastike.
- d. Program për menaxhimin e mbetjeve për institucionet dhe godinat publike.
- e. Sigurimi i një sistemi grumbullimi dhe riciklimi me të paktën katër ndarëse (p.sh. organike, letër, metale, qelq dhe plastik.)
- f. Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm për depozitimin e mbeturinave të mbetjeve të ngurta.
- g. Fushatë për eliminimin e hedhjes së mbeturinave, përfshi nga vizitorët, dhe për mbajtjen pastër të mjediseve publike.
- h. Kosha të përshtatshme për depozitimin e ndarë të mbeturinave.





**D10 Emetimi i Gazrave Serrë dhe reduktimi i ndryshimeve klimatike**

Destinacioni ka objektiva për të reduktuar emetimet e gazrave serrë; ai zbaton dhe raporton për politikat dhe veprimet e ndërmarra. Bizneset inkurajohen të matin, monitorojnë, reduktojnë ose minimizojnë, raportojnë publikisht dhe të reduktojnë emetimin e gazrave serrë nga të gjitha aspektet e operacioneve të tyre (përfshi nga furnitorët dhe ofruesit e shërbimeve). Inkurajohet neutralizimi i çdo emetimi të mbetur.

- a. Objektivat për përqindjen e reduktimit janë publikuar, shoqëruar me datat përkatëse.
- b. Raporti vjetor për klimën, përfshi monitorimin dhe veprimet për reduktimin.
- c. Fushatë ose ndonjë veprimtari tjetër me bizneset e turizmit për reduktimin dhe zbutjen e emetimit.
- d. Veprimtari për reduktimin e emetimit shkaktuar nga operacionete sektori publik.
- e. Informacion për bizneset dhe vizitorët rreth skemave të neutralizimit që përmbushin standardet e miratuara.



<p><b>D11 Transport me impakte të ulëta</b></p> <p>Destinacioni ka objektiva për reduktimin e emetimeve të shkaktuara nga transporti gjatë udhëtimeve për në dhe brenda destinacionit. Po kërkohet rritja e përdorimit të automjeteve të qëndrueshme dhe me emetim të ulët, përdorimi i transportit publik dhe udhëtimet aktive (p.sh., ecja dhe përdorimi biçikletës) në mënyrë që të reduktohet kontributi i turizmit në ndotjen e ajrit, bllokimin e trafikut dhe ndryshimet klimatike.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Investime në infrastrukturë për transport më të qëndrueshëm, përfshi transportin publik dhe automjete me emetim të ulët.</li> <li>Informacioni i promovuar te vizitorët për mundësitë e transportit alternativ për në dhe brenda destinacionit.</li> <li>Të dhëna për vizitorët që përdorin mënyrat e transportit alternativ</li> <li>Përmirësime dhe promovim i çiklizmit dhe mundësive për të ecur.</li> <li>U jepet përparësi tregjeve të vizitorëve që janë në distancë të shkurtër ose me mundësi transporti më të qëndrueshëm.</li> <li>Spektori publik dhe bizneset e turizmit i japin prioritet transportit me impakt të ulët në operacionet e tyre.</li> </ol>	 
<p><b>D12 Light and noise pollution</b></p> <p>The destination has guidelines and regulations to minimize light and noise pollution. The destination encourages enterprises to follow these guidelines and regulations.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Guidelines on light and noise pollution – produced and promoted to tourism enterprises.</li> <li>Identification and monitoring of potential sources of noise and light pollution related to tourism.</li> <li>Mechanisms to enable residents to report noise and light pollution, with follow-up action.</li> </ol>	